

BASHKËPUNIMI I PRINDËRVE NJË FITORE PËR NXËNËS, MËSIMJDHËNËS DHE PRINDËR

„Ç’farë të gjithëve ju përket, duhet zgjidhur nga të gjithë.“

Nga Friedrich Dürrenmatt (fizikanti)

Në dekadat e fundit shoqëria (njerëzore) ka ndryshuar rrënjësisht. Shumë nga detyrat dhe sfidat që rezultojnë nga kjo, shkola dhe prindërit mund t’i zgjidhin vetëm së bashku. Është dëshmuar se; një bashkëpunim i mirë në mes të shkollës dhe prindërve ka efekte pozitive në atmosferën e shkollës dhe kontribuon në suksesin shkollor të fëmijëve dhe të të rinjve. Që ky bashkëpunim të jetë përgjithmonë i sigurtë dhe të bëhet praktikë e mirë, nevojiten struktura të dobishme – bashkëpunim i prindërve në formë të këshillit të prindërve. Kjo plotëson format ekzistuese të mënyrave të kontaktit dhe të formave të bashkëpunimit.

Ku qëndron fitimi për pjesëmarrësit?

Marrëdhëniet prindër-mësues

Prindërit dhe mësuesit njihen më mirë me njëri-tjetrin. Ata punojnë së bashku në grupe pune ose takohen në mbledhje. Krijohet një bazë besimi, mbi të cilën në situata të vështira mund të punohet. Ankthet e shkallëzuara zvogëlohen dhe synimet bëhen relative. Në shkollën e sotme prindërit marrin një pasqyrë nga një këndvështrim tjetër përmes „bashkëpunimi i prindërve“.

Marrëdhëniet prindër-prindër



Familjet pas ceremonive takohen në raste kokteji (Apero) ose në „ngrënien e një mëngjesi të rehatshëm“ në forum të prindërve, të shtunën në mëngjes. Së bashku me përfaqësuesit e klasave të tjera, ju mbështetni shkollën e fëmijëve tuaj. Mbahet një takim mes kulturave të ndryshme. Prindërit përfaqësues të klasës së tyre, në një mbrëmje të prindërve, regjistrojnë tema të rëndësishme dhe shpjegojnë përmes ligjeratave ose diskutimeve kërkesat e tyre. Për shumë prindër shkëmbimi i mendimeve është i rëndësishëm. Është mirë për të dëgjosh se edhe prindërit e tjerë kanë të njëjtat probleme. Prindërit së bashku mund të

kërkojnë zgjidhje ose nevojiten të dhëna nga një person profesional përmes një ligjerate.

Prindërit mësojnë

Për disa prindër takimet e rregullta në mbledhje të këshillit të prindërve, është një sfidë e madhe. Ata mësojnë të shkruajnë protokolle, të udhëheqin takime ose të organizojnë së bashku projekte. Në këtë mënyrë baballarët dhe nënat përfitojnë përvojën për të udhëhequr, të cilën ndoshta më vonë mund t’u zbatojnë në profesionin e tyre. Kështu do të jëtë e dobishme puna vullnetare. Prindërit me prejardhje nga kultura të ndryshme (të huaja), të cilët janë të integruar dhe mund t’i mbështesin bashkëatdhetaret, në vendosjen e tyre të re dhe t’ju lehtësojnë kontaktin e parë me shkollën. Autoritetet zyrtare për kryerjen e detyrave të tyre gjejnë mbështetje (tek këto prindër). Ata mund të marrin reagimet e prindërve në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe pranojnë impulset e vlefshme për ndryshime të domosdoshme.



E kemi bërë „të këndshme“ ?



Elternrat
Schulhaus Hofurri
Postfach 63
8408 Winterthur
<http://hohfurri.schule-winterthur.net>